



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0620**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 21 dhe 29 të Rregullores 01/20220 e amenduar me 09. 08. 2023, në përbërje nga Agon Ramadani Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Vedat Poterqoi Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Milenium Konstruktion” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1, me 03/11/2023, mori:

## Vendim

1. **Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e OE “Milenium Konstruktion” SH.P.K. me nr. 2023/0620, e datës 25/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-22-11624-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Milenium Konstruktion” SH.P.K.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 18.07.2023, ka paraqitur Njoftimin për kontratë- B05, për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontejner për mbeturina” me numër prokurimi: 616-23-7124-1-1-1.

Me datën 02.08.2023, AK ka publikuar vendimin B58 për dhënie të kontratës operatorit ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”; “Marisa” SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K.

Me 07.08.2023, OE "Milenium Konstruktion" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 15.08.2023, AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Milenium Konstruktion" SH.P.K. i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me 25.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 620/23.

*- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale ku të dyja palët kanë deklaruar se nuk pajtohen me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

*Pretendimet e Ankuesit "Milenium Konstruktion" SH.P.K*

- Pretendimi i parë (I)*- Fillimisht ju sqarojmë se ne për këtë aktivitet të prokurimit përkatësisht për lot II jemi rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt. 19.01.2023, pra sipas AK-së ne kemi qenë OE të përgjegjshëm në njoftimin mbi vendimin e AK-së, mirëpo çuditërisht tani pas rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ne po eliminohe mi me arsyetime krejtësisht të pa bazuara, se kinse sqarimet e dhëna nga ne gjatë fazës së rivlerësimit nuk kanë qenë bindëse. Konstatimi i lartcekur i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm për faktin se pozicioni 4.2 (furnizim me beton) dhe 4.3 (furnizim me armature) nuk punohen ndaras, por janë të ndërlidhura ndërmjet vete. Çdo person edhe atë të cilët nuk janë kompetent në fushën e ndërtimit e dijnë se armatura është e ndërlidhur me betonin, pasi që betoni përdoret në vendet ku vendoset armatura. Ne me përgjigjet të cilat i kemi dhënë pasi që AK-ja na ka kërkuar sqarime shpeshë ne e kemi sqaruar shumë qartë se kur analizohet pozicioni nr.4.2 dhe pozicioni nr.4.3, kuptohet se pozicioni nr.4.2 është domosdoshmërisht i ndërlidhur me pozicionin nr.4.3, pasi që themelet, muret dhe lëshesat betonarme të kërkuara tek pozicioni nr.4.3 nuk mund të realizohen pa pozicionin nr.4.2. Gjatë kalkulimit të çmimeve për betonin e klasit C25/30 për themelet, mure dhe lëshesa të betonarmes  $1m^3$  kemi dhënë çmimin prej 10.00 euro, ndërsa tek vendosja në vepër e armaturës (80kg për  $m^3$ ) kemi bërë kalkulimin si në vijim:  $80kg/m^3 * 3.5 € = 280€$ . Kur punohen pozicionet e lartcekura së bashku, atëherë çmimi për 1  $m^3$  beton me armaturë del të jetë 290.00 euro për  $m^3$ . Megjithatë edhe përkundër këtyre fakteve ne edhe një herë po e bashkëngjisim marrëveshjen ndërmjet firmës tonë dhe kompanisë furnizuese me beton dhe armaturë, të cilat garantojnë furnizimin me material për këto dy pozicione, pa marrë parasysh se a do të bëhet furnizimi bashkërisht, apo edhe veç e veç për këto dy pozicione nëse është nevoja. Duke u bazuar në kalkulimet të cilat ne i kemi bërë dhe faturat të cilat i kemi prezantuar kuptohet qartë se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne nuk janë çmime jo normalisht të ulëta dhe sqarimet të cilat ne i kemi dhënë është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues, mirëpo që një gjë e tillë nuk ka ndodhur, duke u diskriminuar ne si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Se autoriteti kontraktues na ka diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ky fakt vërtetohet edhe kur analizohet kontrata të cilën AK-ja e ka nënshkruar me OE INTEGRAL SH.P.K. për këtë aktivitet të prokurimit, përkatësisht për Lot 1. Kur analizohet paramasa e këtij OE me të cilin AK-ja ka nënshkruar kontratë, vërtetohet fakti se edhe ky OE për dy pozicionet të cilat janë të njëjta me pozicionet të cilat tani janë duke u kontestuar, ka dhënë çmimin e njëjtë tek pozicioni nr.4.2 mirëpo këtë fakt AK-ja nuk e ka marrë parasysh pasi që me të njëjtin OE AK-ja ka nënshkruar kontratë. Në këtë rast kuptohet qartë se autoriteti kontraktues për çmime të njëjta të pozicioneve të njëjta po përdor standarde të dyfishta duke nënshkruar kontratë me një OE, ndërsa neve na eliminon me arsyetimin se kinse kemi ofertuar me çmim jo normalisht të ulët. Për të vërtetuar faktin se ne jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë me çmimet me të cilat kemi ofertuar, ju sqarojmë se ne jemi në gjendje të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit aq sa AK-ja e shoh të arsyeshme edhe 20%, 30 % apo 50 e edhe më tepër, si garancion se ne mund ta përfundojmë këtë projekt me kohë dhe në mënyrë profesionale me çmimet që ne i kemi ofruar.
- Pretendimi i dytë (II)*- Grupi i OE “Victory Com”; “Marisa” dhe “Company Murseli” shpk të rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm për arsyet si në vijim: Kur analizohet oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, përkatësisht paramasa dhe paralogaria e të njëjtit kuptohet qartë se të njëjtit kanë ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta për faktin se nëse e njëjta krahasohet me objektin e kontratës shihet se ka dallime substanciale ne raport me çmimet reale të tregut. Çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë janë çmime manipulative, jo normalisht të ulëta dhe njëkohësisht çmime të cilat nuk përkojnë fare

me çmimet e tregut, të cilat do ti sqarojmë më poshtë: Tek pozicioni nr.1.1. dhe 1.2. - Punët Përgatitore 1.1. Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues në vend punishte. 1.2. Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e defekteve. OE i rekomanduar për kontratë për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 1.1. dhe pozicionin 1.2. ka ofertuar me çmim prej 1.00 euro çmim njësi për secilin pozicion. Kur kemi parasysh çmimet e tregut çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, nuk përkojnë fare me çmimet aktuale të tregut, mirëpo për çudi autoriteti kontraktues nuk i ka pasur parasysh fare këto çmime, duke e rekomanduar për kontratë. Nga një analizë dhe përlllogaritje e thjeshtë, rezulton se çmimi i ofertuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është shumë herë më e ulët se çmimi mesatar dhe real i tregut. Për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 2.2. dhe pozicionin 2.4. OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 1.00 euro çmim njësi për secilin pozicion. Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendor kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk përkon fare me çmimet reale të tregut sepse nuk mund të realizohen pozicionet e lartcekura me çmim prej 1 euro pasi që të njëjtat siç edhe e cekëm nuk janë fare në harmoni me çmimet e tregut dhe janë çmime jo normalisht të ulëta. Minimumi i çmimit për pozicionin 2.4. në treg sillet rreth 2.00 euro, andaj është e pamundshme që të përfundohet pozicioni i tillë me çmimin më të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe i njëjti OE nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

2.2 Preerja (mënjanimi) i drunjeve dhe shkurreve ekzistuese, si dhe pastrimi i terrenit me transport deri në 15 km; m 1 1.00 0.01 1.00; 2.4 Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstitit 400gr/m<sup>2</sup> m<sup>2</sup> 1 1.00 0.04 4.00; 2.6 Hapja e kanalit anësorë në formën e trapezitet në tere gjatësinë e rrugës. Dimensionet e kanalit (thellësia h=100cm, gjerësia pjesa e poshtme e kanalit bp=50cm, si dhe pjesa e sipërme e kanalit bs=150cm). m 1 1.00 0.02 2.00; Tek pozicioni 3 (punët e zhavorrit) nën pozicioni 3.2, 3.3 & 3.4; 3.2. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=50 Mpa., 0- 100 mm; 3.3. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=60 Mpa. 0- 63 mm; 3.4. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=70 Mpa., 0- 31 mm. Për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 3.2. ka ofertuar me çmimin prej 4.50 euro për m<sup>3</sup>, ndërsa për realizimin e punimeve të pozicionit 3.3 dhe 3.4 ka ofertuar me çmimin prej 8.00 euro për m<sup>3</sup>. Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendor kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korrespondon fare me çmime reale të tregut sepse në treg nuk ka çmim prej 4.50 euro dhe 8.00 euro për realizimin e këtyre pozicioneve. Sa për sqarim minimumi i blerjes së zhavorrit të këtyre karakteristikave është 8 euro për m<sup>3</sup> tek gurëthyesi për ta blerë, ndërsa pastaj pasi të kalkulohet transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit, çmimi minimal real duhet të jetë së paku 11.00 euro për m<sup>3</sup>. 3.2 Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=50 Mpa. ,0-100 mm m<sup>3</sup> 1.00 4.50; 3.3 Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=60 Mpa. , 0- 63 mm m<sup>3</sup> 1.00 8.00; 3.4 Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar të pastër dhe ngjeshja e tij me modul të ngjeshmërisë Mt=70 Mpa., 0- 31 mm m<sup>3</sup> 1.00 8.00. Pozicioni 4

(punët e betonit) nën pozicioni 4.1. Furnizimi, transporti kallëpimi vendosja kompaktimi i betonit të thjeshtë C 10/16 si bazë për elemente mbrojtës. OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me pozicionin e lartcekur ka ofertuar me çmim manipulativ prej 35.00 euro çmim njësi për pozicion. Kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korresponon fare me çmime reale të tregut pasi që çmimi për m<sup>3</sup> i betonit sipas indeksit të çmimeve të publikuara nga AQP dhe KRPP sillet afro 70 deri 90 euro, sepse nuk ka çmim prej 35.00 euro në realizimin e këtij pozicioni me çmimet e tregut. Pra, nga një analizë dhe përlllogaritje e thjeshtë, rezultojnë se çmimi i ofertuar nga ana e OE në fjalë është shumëfish herë më e ulët se çmimi mesatar i tregut. Furnizimi, transporti kallëpimi vendosja kompaktimi i betonit të thjeshtë C 10/16 si bazë për elemente mbrojtës. m<sup>3</sup> 1 35.00 0.04 0.10. Pozicioni 5 (punët e lëshesave) nën pozicioni 5.1. Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikëqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (në çmim të llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor). OE i rekomanduar për kontratë për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 5.1. ka ofertuar me çmim manipulues prej 10.00 euro - 20.00 euro për m. Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendosja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korresponon me çmime reale të tregut sepse nuk ka çmim 10.00-20.00 euro në realizimin e këtyre pozicioneve të cimit e tregut. Pra, nga një analizë dhe përlllogaritje e thjeshtë, rezultojnë se çmimi i ofertuar nga ana e OE në fjalë është shumë më e ulët se çmimi mesatar i tregut. 5.1 Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikëqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (në çmim të llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor). Gyp prej betoni të armuar 0 1200 mm m 1 20.00. Gyp prej betoni të armuar 0 1000 mm m 1 20.00. Gyp prej betoni të armuar 0 800 mm m 1 15.00. Gyp prej betoni të armuar 0 600 mm m 1 15.00. Gyp prej betoni të armuar 0 500 mm m 1 10.00. Gyp prej betoni të armuar 0 400 mm m 1 20.00. Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo çuditërisht autoriteti kontaktues nuk i ka marrë parasysh fare këto fakte, pasi që e ka rekomanduar për kontratë duke mos i kërkuar as sqarime fare. Përderisa AK-ja nuk i ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa në tjetrën anë neve na ka kërkuar sqarime shpesh dhe pasi që i kemi dhënë përgjigjet na ka eliminuar me arsyetimin se kinse përgjigjet tona nuk janë bindëse. Në këtë rast shihen qartë standardet e dyfishta që AK-ja i ka përdorur për këtë aktivitet të prokurimit, në raport me çmimet me të cilat kemi ofertuar ne dhe çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe dispozitat e nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik pasi që nuk ka dërguar grupit të OE të rekomanduar për kontratë Letër Standarde për Sqarim të tenderëve për çmime jo-normalisht të ulëta. Në bazë të të gjitha fakteve dhe provave të paraqitura, rezultojnë se tenderi i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë përbën tender jo-normalisht të ulët për faktin se është krijuar mbi bazën e çmimeve manipuluese, të ulëta me dallim disa herë nën nivelin e çmimeve reale të tregut dhe burimeve të besueshme siç janë çmimet e publikuara nga Zyra e Statistikave të Kosovës dhe/ose çmimet tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike). Andaj kjo ofertë e cila si e tillë ka dallim substancial me çmimet reale të tregut rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës dhe kufizon/shtrembëron konkurrencën e lirë të OE ankues dhe tenderuesve tjerë në raport me ofertimet të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat dhe çmimet reale të tregut.

- *Pretendimi i tretë (III)*- Në më datë 15.08.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku AK-ja e ka cilësuar kërkesën si të pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë

fakte dhe argumente konkrete në lidhje me refuzimin që e ka bërë. AK-ja në vendimin për refuzim e ka cekur se kinse ne nuk e kemi kontestuar fare faktin se kinse kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi sqaruar shumë qartë në kërkesë për rishqyrtim dhe tani në ankesë se çmimi me të cilin kemi ofertuar ne nuk është në asnjë mënyrë çmim jo normalisht i ulët. Për këtë fakt i kemi prezantuar edhe marrëveshjet dhe faturat në mes të kompanisë tonë dhe kompanisë furnizuese me beton dhe armaturë, përmes të cilave garantohej furnizimin me material për këto dy pozicione, pa marr parasysh se a do të bëhet furnizimi bashkërisht, apo edhe veç e veç për këto dy pozicione nëse është nevoja, mirëpo çuditërisht AK-ja nuk i ka marr parasysh fare këto dëshmi. Në faturën që ne e kemi prezantuar nga Metal Mix SHPK, shihet sasia e blerë dhe në momentin që bëhet kalkulimi i kg me vlerën e çmimit të faturës, figuron se çmimi për një kilogram armaturë është 0.57 cent, ndërsa ne kemi ofertuar me çmim prej 3.50 euro, duke i llogaritur këtu furnizimin, transportin, prerjes lakimin etj. Ky fakt nënkupton që çmimi me të cilin kemi ofertuar ne nuk është çmim jo normalisht i ulët. Ndërsa çmimi i dhënë tek pozicioni nr.4.2. ju sqarojmë se ky çmim është dhënë nga ne pasi që janë bërë kalkulimet, duke e llogaritur një kubik beton me 80 kg armaturë, ku çmimi total për pozicionin 4.2 dhe 4.3 i bie të jetë 290.00 euro. Vendimi të OSHP-së të cilit i është referuar AK-ja ju sqarojmë se në të njëjtin vendim askund nuk ceket se ne kemi ofertuar me çmim jo normalisht të ulët, mirëpo theksohet qartë se duhet të kërkohen sqarime shtesë nëse çmimi me të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë duket jo normalisht i ulët, gjë që të cilën e keni bërë mirëpo nuk i keni marr parasysh fare sqarimet tona duke i konsideruar jo bindëse. Sa i përket arsyetimit të AK-së ku e njëjta në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë e ka cekur se kinse ne nuk kemi treguar se mbi cilën bazë ligjore dhe logjike e kemi bërë kalkulimin e çmimeve, ju sqarojmë se ky arsyetim është i paqëndrueshëm sepse ne gjatë kalkulimit të çmimeve kemi marrë për bazë çmimet e tregut. Ndërsa autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka përdorur standarde të dyfishta sepse, në lidhje me çmimet për pozicionet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk ka marr për bazë çmimet e tregut, ndërsa në anën tjetër në raport me çmimet e ofruara nga ne konsideron se kemi ofruar çmime jo normalisht të ulëta, e që çmimet jo normalisht të ulëta mund të konsiderohen vetëm nëse krahasohen me çmimet e tregut. Pra AK-ja ka qenë e njëanshme në vlerësim dhe është treguar favorizuese në raport me OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminuese në raport me kompaninë tonë, andaj ky veprim i AK-së bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Në asnjë moment autoriteti kontraktues nuk e merr parasysh asnjërin nga pretendimet tona ankimore edhe pse e kemi cekur shumë qartë se sa është çmimi i tregut për pozicionet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë ku vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim në asnjë mënyrë nuk e kundërshton ndonjërin nga pretendimet tona ankimore në lidhje me çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo në secilin rast i referohet ofertës në përgjithësi dhe e cek se kinse nuk janë ofruar dëshmi konkrete për çmimet e OE të rekomanduar për kontratë. Përderisa AK-ja nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore në lidhje me çmimet e OE të rekomanduar për kontratë, kuptohet qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara. Gjithashtu autoriteti kontraktues ka devijuar edhe nga konstatimet e panelit shqyrtues të OSHP-së në vendimin nr.PSH.nr.6I/23, pasi që në të njëjtin vendim askund nuk ceket që ne kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo specifikohet saktë se nëse çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar duken çmime jo normalisht të ulëta, atëherë duhet të kërkohen sqarime shtesë konform nenit 61 të LPP-së. Kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së dhe

eksperti shqyrtues ti analizojnë në tërësi faktet dhe dëshmitë tona në lidhje me çmimet me të cilat kemi ofertuar dhe gjithashtu kërkojmë të analizohen në tërësi pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, pasi që në këtë aktivitet të prokurimit, janë përdorur standarde të dyfishta nga ana e AK-së dhe njëkohësisht është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezultojnë se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

### *Konstatimet e ekspertit shqyrtues*

*Sqarim Hyrës:* Fillimisht e shohim të nevojshme të theksojmë se AK në rastin konkret, marrë parasysh natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, AK ka mund të bëjë planifikim dhe identifikim të saktë të nevojave të veta duke vendosur të paktën sasi të e përafërta për gjitha pozicionet. E jo si në rastin konkret ku është përcaktuar për kriter me peshim të çmimeve pa asnjë sasi të parashikuar. Kjo praktikë e AK-ve në përgjithësi si në rastin konkret krijon hapësirë më madhe për OE-të për manipulim me çmimet e ofruara, ashtu siç është bërë objekt i shqyrtimit në rastin konkret. Megjithatë as ankesa 61/23 e as ankesa 620/23 nuk e kanë ngritur këtë çështje, dhe konsiderojmë se anulimi i aktivitetit në këtë kohë do të shkaktonte vonesa dhe shpenzime shtesë për AK, andaj rekomandimi jonë dhe përgjigjet në ankesë i gjeni si në vijim.

- *Konstatimi i parë (I)*- Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 620/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta lidhur me pozicionin për beton, ku ka ofruar metër kub të betonit me çmim 10€. Pikërisht për këtë çështje paraprakisht në OSHP është parashtruar ankesa 61/23 nga OE “Victory” (tani OE i rekomanduar për kontratë), pas së cilës ankesë eksperti shqyrtues/Teknik i OSHP-së në raportin e ekspertit nr.61/23, ka konstatuar se çmimi këtij pozicioni është disa here më i lirë se çmimi real i tregut. Pas raportit të ekspertit 61/23 OSHP ka nxjerr vendim përmes të cilit OSHP vendos që AK duhet të veproj sipas nenit 61 të LPP dhe nenit 41 të rregullores për prokurim publik paragrafi 41.6, që AK duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zberthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët". AK me rastin rivlerësimi ka kërkuar sqarime nga OE dhe po ashtu ka pranuar sqarim se pozicioni për beton është i lidhur ngushtë me pozicionin pasues për armaturë, ngase themelet, muret dhe lëshesat betonarme nuk mund të realizohen pa armaturë pasi armatura është kërkuar 80kg për metër kub. Andaj OE ankues pretendon se këto dy pozicione në kombinim 10€ metri kub i betoni dhe 280€ për 80kg në metër kub japin çmimin 290€. AK nuk është bindur nga sqarimi i ofruar nga OE dhe të njëjtin e ka eliminuar për çmim jo normalisht të ulët. Pas analizimit të pretendimeve

ankimore, vendimit të AK-së, e në veçanti pas analizimit të raportit të ekspertit nr.61/23, mendimi ekspertit shqyrtues është se çmimi 10€ për metër kub të betonit është çmim jo normalisht i ulët kë krahasim me çmimet e tregut, ku çmimi tregut është për mbi 70€ për metër kub. Ndërsa çmimi i armaturës 3.50€ për kilogram, është çmim dukshëm më i lartë se çmimi tregut. Ky kombinim i këtyre dy pozicioneve me këto çmime sipas mendimit tonë rrezikon realizimin.

- *Konstatimi i dytë (II)*- Pretendimet e OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë për pozicione me çmime jo normalisht të ulëta, AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk i është përgjigjur konkretisht për pozicionet e kontestuara, duke pretenduar se për OE të rekomanduar nuk plotësohet kushti që çmimi të jetë 30% më ulët se mesatarja çmimeve të ofruara, andaj edhe komisioni nuk e ka pa të arsyeshme të kërkoj sqarime shtesë. Pas analizimit të pretendimeve ankimore të OE ankues kundrejt pozicioneve të OE të rekomanduar, ku në shumë pozicione si mobilizimi ndërmarrjes për fillimin e punimeve, kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore etj. ka ofruar çmim 1€. Eksperti shqyrtues vlerëson se pavarësisht kushtit 30% në krahasim me çmimet tjera, edhe për pozicione të caktuara nëse duket se çmimet janë jo normalisht të ulëta, si në rastin e ankesës 61/23 AK do duhej të kërkoj sqarime dhe deklaratë nga OE i rekomanduar. Andaj konsiderojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara, në kuptim që që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të kërkojen sqarime konform neni 61 të LPP-së dhe 41.6 të rregullores 001/2022.

#### *Konstatimet e Panelit Shqyrtues*

Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit dhe vlerëson se ankesa e OE “Milenium Konstruktion” SH.P.K është pjesërisht e bazuar.

Në fakt Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

Lidhur me ankesën si objekt shqyrtimi, vlen të theksohet se rrethanat kryesore të paraqitura në rastin konkret qëndrojnë mbi faktin ku OE ankues ka ngritur pretendime mbi eliminimin e tij dhe poashtu kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues nga ky aktivitet, Paneli Shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues me vendimin paraprak të referuar si më sipër ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna, ku është evidentuar fakti që oferta e OE të rekomanduar ka përmbajtur çmime jo të tregut sipas ekspertit shqyrtues të cilit i ju kishte falur besimi, ndërsa tanimë i njëjti ka statusin e ankuesit i cili është eliminuar nga ky aktivitet prokurimi, andaj duke konsiderur se rrethanat e zhvilluara ku AK-ka ka kërkuar sqarime shtesë edhe nga ankuesi por nuk është bindur me çmimet e ofruara, duke e refuzuar kështu ofertën e OE si ofertë me çmim jo



normalisht të ulët, e poashtu duke konsideruar se edhe eksperti shqyrtues ka rekomanduar se ky pretendim lidhur me çmimin e ofertuar të trajtohet si i pabazuar, paneli shqyrtues ka arritur në vendim-marrjen që çmimi i ofertuar në lidhje me 10€ për metër kub të betonit është çmim jo normalisht i ulët në krahasim me çmimet e tregut si dhe në këtë pikë pajtohet me raportin e ekspertit, për të arritur në këtë vendim-marrje poashtu është konsideruar se pohimet ankimore të OE ankues nuk kanë përmbajtur argumente, fakte, të gjetura si dhe dëshmi konkrete në relacion me çmimet e ofertuara ashtu siç përcaktohet me nenin 61 të LPP-së, në mënyrë që nga ana e panelit ky pretendim të klasifikohet si i bazuar, megjithatë duhet theksuar se legjislacioni në fuqi i referohet AK-së si përgjegjës dhe i jep ushtrimin e diskrecionit që të bindet me ofertat dhe çmimet jo-të tregut andaj edhe sqarimet e dhëna nga OE ankues kanë qenë jo-bindëse për AK-në, kështu që rrjedhimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, OE ankues nga ana e panelit klasifikohet si i papërgjegjshëm lidhur me këtë aktivitet prokurimi andaj eliminohet nga pjesëmarrja në të.

Lidhur me pretendimin kundrejt OE të rekomanduar, PSH konstaton se mbështetet në raportin e ekspertit se lidhur me pozicione të caktuara qëndron nevoja që për të njëjtat të kërkohen sqarime lidhur me çmimet e ulëta, kështu që Paneli në vlerësimin e tij të pavarur shqyrtoj edhe pretendimet e OE ankues kundrejt OE të rekomanduar për kontratë për pozicione me çmime jo normalisht të ulëta, dhe vlerëson se AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk i është përgjigjur konkretisht për pozicionet e kontestuara OE ankues, duke pretenduar se për OE të rekomanduar nuk plotësohet kushti që çmimi të jetë 30% më ulët se mesatarja çmimeve të ofruara, andaj edhe komisioni nuk e ka pa të arsyeshme të kërkoj sqarime shtesë, por pavarësisht kushtit 30% në krahasim me çmimet tjera, edhe për pozicione të caktuara nëse duket se çmimet janë jo normalisht të ulëta, si në rastin e ankesës 61/23 AK do duhej të kërkoj sqarime dhe deklaratë nga OE i rekomanduar, kjo poashtu duke u bazuar në trajtimin e barabartë të palëve si parim themelor i LPP-së lidhur me nenin 41 të RRPP 41,4 cituar kur *tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.*

- Përfundim –

Paneli shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar janë pjesërisht të bazuara, andaj konstaton se lënda duhet të kthehet në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime shtesë nga OE i rekomanduar konform neni 61 të LPP-së dhe 41.6 të rregullores 001/2022, ndërsa pretendimet mbi përgjegjshmërinë e tij klasifikohen si të pabazuara.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues nisat gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Agon Ramadani**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - MILENIUM KONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: